



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



04/ 1592 /2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR MUAJIN JANAR 2026

Hani i Elezit, 2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin Janar 2026, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësi, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë muajit Janar 2026 kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale për muajin Dhjetor 2025,
- Barazimi me Thesar periudha Janar-Dhjetor 2025,
- Është dërguar për publikim borxhi publik i muajit Dhjetor 2025 në ueb faqen komunale,
- Përgatitja dhe publikimi i raportit të punëve dhe aktiviteteve të muajit Dhjetor 2025, në dy formate: Word dhe PDF,
- Hartimi i raportit mujor të të hyrave dhe shpenzimeve të muajit Dhjetor 2025,
- Hartimi i Raportit Financiar Janar-Dhjetor 2025 në tri formate: Word, PDF dhe Excel,
- Diskutimi në Kuvend Komunal i Raportit Financiar Janar-Dhjetor 2025,
- Fillimi i procesit të Auditimit të PVF 2025 nga ZKA,
- Hartimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2025,
- Dorëzimi i PVF 2025 në Departamentin e Thesarit – MFPT,

- Dorëzimi i Raportit të Monitorimit sipas periudhave (Q4) për investimet kapitale 2025 në Departamentin e Buxhetit – MFPT,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor.

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR MUAJIN JANAR 2026

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Realizimi Janar 2026
Paga dhe shtesa	198,256.35
Mallra dhe shërbime	170,837.78
Shpenzime komunale	7,491.20
Subvencione dhe trans.	1,000.00
Shpenzime kapitale	-
TOTAL	206,747.55

SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2026 është në shumë prej 356,720.00 €. Inkasimi i të hyrave për muajin Janar është në shumë prej 7,735.04 €.

- Regjistrimi, harmonizimi i të hyrave ditore në SIMFK,
- Pranimi i të hyrave indirekte për TM4, nga Divizioni i të hyrave – MFPT, prej të cilave nga Gjobat në trafik për këtë periudhë shuma e inkasuar është në vlerë prej 33,100.00 €.

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka kryer shërbime të rregullta ndaj qytetarëve, siç janë:

- Lëshimin e faturave të tatimit në pronë,
- Lëshimin e vërtetimeve për qëllime të ndryshme,

Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

